



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 138, Datë 10.07.2024

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “KROI MBRET ENERGJI” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, 13 dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin, dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.07.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1028/6 prot., datë 08.07.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “KROI MBRET ENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr.105, datë 31.05.2024 vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 456, Seria T19, të shoqërisë “KROI MBRET ENERGJI” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 192, datë 02.12.2019, për një afat 5-vjeçar.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 01.06.2024 dhe 03.06.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.06.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u publikua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 1028/4 prot., datë 10.06.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin për fillimin e procedurës dhe kërkesën për plotësimin e dokumentacionit për të vijuar me procedurën për rinovim.

- Në vijim, shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1028/5 prot., datë 04.07.2024 ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Dokumentacioni i këtij aplikimi rezulton tërësisht i plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën nr. 456, Seria T19, të shoqërisë “KROI MBRET ENERGI” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 192, datë 02.12.2019, për një afat 5 vjeçar, duke filluar nga data 03.12.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI